



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 18 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes dhe çështjeve të lidhura me të

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bouden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Hendrik Sitema

GJYKATËSI I PROCEDURËS PRAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 92(2)(c) dhe 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 9 dhjetor 2020, në pajtim me procesin e rishikimit dymujor të masës së paraburgimit të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi palët që, deri më 18 dhjetor 2020 të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit të Hysni Gucatit ("z. Gucati") dhe Nasim Haradinajt ("z. Haradinaj"), apo nëse paraburgimi i tyre duhet të përfundojë.²

2. Më 18 dhjetor 2020, në vijim të dorëzimit të aktakuzës së konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("Aktakuza e Konfirmuar") z. Gucati dhe z. Haradinaj (bashkërisht, "të akuzuarit"),³ u mbajtën paraqitjet e para të tyre.⁴ Gjatë paraqitjeve të tyre përkatëse, z. Haradinaj shtyu vetëdeklarimin në lidhje me

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00073, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për parashtrime për rishikimin e paraburgimit*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 11.

³ KSC-BC-2020-07, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës*, 11 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Aktakuza e konfirmuar akuzon z. Gucati dhe z. Haradinaj me shkelje sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji Nr. 06/L-074, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit. F00075/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e konfirmuar*, 14 dhjetor 2020, publike.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00081, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i dytë për ndryshimin e orarit të paraqitjeve të para të z. Gucati dhe z. Haradinaj*, 17 dhjetor 2020, publik.

fajësinë apo pafajësinë deri në seancën vijuese,⁵ ndërsa z. Gucati u vetëdeklarua i pafajshëm.⁶

3. Më 18 dhjetor 2020, Mbrojtja për z. Gucati paraqiti parashtrimet e veta lidhur me rishikimin e paraburgimit, duke kërkuar, ndër të tjera, që të mbahet një seancë gojore lidhur me këtë çështje para 27 dhjetorit 2020.⁷ Po atë ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti parashtrimet e veta përmbledhëse lidhur me rishikimin e paraburgimit.⁸ Në paraqitjen e parë të lartpërmendur të z. Gucati, Mbrojtja e tij përsëriti kërkesën për një seancë gojore dhe, si alternativë, kërkoj mundësinë të kundërpërgjigjet në lidhje me parashtrimet e ZPS-së lidhur me rishikimin e paraburgimit.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. SEANCA PËR VETËDEKLARIM NË LIDHJE ME FAJËSINË OSE PAFAJËSINË

4. Në bazë të rregullës 92(2)(c) të Rregullores, i akuzuari mund të pranojë fajësinë apo të deklarohej i pafajshëm për çdo akuzë, ose në paraqitjen e tij të parë, ose brenda 30 ditësh prej mbajtjes së saj. Sipas rregullës 92(2)(f) të Rregullores, nëse i akuzuari nuk pranon fajësinë ose nuk deklarohej i pafajshëm në seancën e paraqitjes së tij të parë ose paraqitjeve vijuese, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën deklarimin në emër të të akuzuarit se i akuzuari është i pafajshëm.

⁵ KSC-BC-2020-07, Transkript në kohë reale, 18 dhjetor 2020 (11:00), konfidencial, f. 12, rreshtat 24-25 deri f. 13, rreshtat 1-10.

⁶ KSC-BC-2020-07, Transkript në kohë reale, 18 dhjetor 2020 (14:00), konfidencial, f. 11, rreshtat 24-25 deri te f. 13, rreshtat 1-10.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00087, Mbrojtja për z. Gucati, *Parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit deri më 27 dhjetor 2020*, 18 dhjetor 2020 (me datë gabim 17 dhjetor 2020), konfidencial, para. 31.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00088, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me rishikimin e paraburgimit*, 18 dhjetor 2020, publike.

⁹ KSC-BC-2020-07, Transkript në kohë reale, 18 dhjetor 2020 (14:00), konfidencial, f. 15, rreshti 23 deri në f. 16, rreshtat 1-3.

B. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

5. Në bazë të Rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, me qëllim që, ndër të tjera: (i) të organizojë shkëmbimin midis palëve për të mundësuar përgatitje të shpejta për gjykimin; dhe (ii) të ndërmerren hapat përkatës për të siguruar se të gjitha përgatitjet e nevojshme nga palët bëhen në kohë dhe në mënyrë të zellshme.

C. NXJERRJA E MATERIALIT

6. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit duhet t'i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, objekt vetëm i kufizimeve rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i dorëzon Mbrojtjes njoftim të hollësishëm të çdo materiali dhe prove që ka në posedim.

7. Në pajtim me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 105, 106, 107, të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialin mbështetës për aktakuzën e konfirmuar si dhe çdo deklaratë të marrë nga i akuzuari sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën 30 ditë para paraqitjes së parë.

8. Në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialin në vijim: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërras të dëshmojnë në gjykim në një gjuhë të cilën i akuzuari e kupton dhe e flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet, ose transkriptimet të cilat ZPS-ja

synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) të gjitha provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

9. Në pajtim me rregullat 102(2) dhe (4) të Rregullores, çdo deklaratë e dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, të cilat nuk janë dorëzuar brenda afatit 30 ditësh para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim, i vihen në dispozicion Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundshme, në një gjuhë të cilën i akuzuari e kupton dhe e flet, dhe së bashku me arsyetimin për vonesën në nxjerrjen e tyre. Kjo nxjerrje e informacioneve finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

10. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes, pas kërkesës dhe pa vonesë, çdo deklaratë, dokument dhe fotografi dhe lejon këqyrjen e sendeve tjera të prekshme nën ruajtjen apo kontrollin e ZPS-së, të cilat Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit.

11. Në pajtim me rregullën 103 të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja vë menjëherë në dispozicion të Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit apo të ndikon në besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e provave të ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së.

12. Në pajtim me rregullën 107(1)-(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë trupit gjykues, konfidencialisht dhe *ex parte*, për t'u liruar tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi sipas rregullave 102 dhe 103 të Rregullores për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin ka nën ruajtje ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e mbledhjes së provave të reja dhe për të cilën nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit për ta nxjerrë.

D. REDAKTIMET

13. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores, një trup gjykues mund të urdhërojë masa të duhura mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore, si dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët.

14. Në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii) dhe (d) të Rregullores, këto masa mund të përfshijnë redaktimin e emrave dhe informacione të tjera identifikuese në mënyrë që të parandalohet zbulimi i tyre të akuzuarit dhe/ose publikut, ku është e nevojshme, e identitetit të dëshmitarit dhe/ose vendndodhja e dëshmitarit, e viktimës pjesëmarrëse në procese gjyqësore ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër.

15. Në pajtim me rregullën 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë trupit gjykues, konfidencialisht dhe *ex parte*, për mosnxjerrjen e informacionit në tërësi ose pjesërisht, atëherë kur nxjerrja e një informacioni të tillë, mund të dëmtojë, ndër të tjera hetimet në kryerje e sipër ose hetime të ardhshme. Në pajtim me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

III. DISKUTIM

A. KËRKESË PËR NJË SEANCË GOJORE OSE PËR DORËZIMIN E KUNDËRPËRGJIGJEVE

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, vë në dukje se procesi i rishikimit dymujor të masës së paraburgimit, kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe të japë vendimin me të cilin paraburgimi zgjatet apo përfundohet. Për procesin e rishikimit që pritët të kryhet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se marrja e parashtrimeve njëherësh nga palët, sipas urdhrit, i mjaftojnë atij për të dhënë vendimin në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe në këtë fazë nuk janë të nevojshme parashtrime shtesë me shkrim apo me

gojë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vë në dukje afatin e afërt për rishikim dymujor, i cili do të rrezikohej me tej në rast se lejohen parashtrime shtesë nga palët. Kjo nuk i ndalon Mbrojtjes të parashtrojë kundërshtime veças mbi mbajtjen në paraburgim ose të paraqesë kërkesa për lirim të përkohshëm ose me kusht sipas nenit 41(2) dhe (12) të Ligjit dhe rregullave 56(3) dhe 57(2) të Rregullores.

17. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kërkesën e Mbrojtjes së z. Gucati për një seancë gojore ose mundësi për parashtrimin e një kundërpërgjigjeje në lidhje me parashtrimin e ZPS-së mbi paraburgim.

B. SEANCA E VETËDEKLARIMIT TË FAJËSISË OSE PAFAJËSISË DHE KONFERENCA E PARË MBI ECURINË E ÇËSHTJES

18. Duke marrë parasysh disponueshmërinë e Mbrojtjes, dhe afatin e përcaktuar në rregullën 92(2)(c) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, urdhëron mbajtjen e seancës, të premten, më 8 janar 2021, në orën 15:00.

19. Gjatë pjesës së parë të seancës, në pajtim me rregullën 92(2)(c) të Rregullores, nga z. Haradinaj do të kërkohet të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm lidhur me akuzat kundër tij në Aktakuzën e Konfirmuar. Në qoftë se z. Haradinaj refuzon të bëjë një gjë të tillë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të deklarojë pafajësinë në emër të tij, në pajtim me rregullën 92(2)(f) të Rregullores.

20. Pjesa e dytë e seancës do të shërbejë si konferencë e parë mbi ecurinë e kësaj çështjeje. Duke marrë parasysh paraqitjet e para të të akuzuarve, procesi i nxjerrjes së provave dhe materialit nga ZPS-ja për Mbrojtjen pritet të fillojë pa vonesë, në pajtim me kornizën ligjore dhe në mënyrën dhe afatin që do të përcaktohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Për të lehtësuar këtë proces të nxjerrjes së materialit në të mirë të palëve, veçanërisht Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të marrë parashtrime lidhur me: (i) materialet e renditura në shtojcën e këtij urdhri ("Rendi i

ditës i bashkëngjitur”); (ii) sistemin e redaktimit të miratuar për këtë proces gjyqësor, siç shtjellohet më tej paragrafin 22 të mëposhtëm; dhe (iii) çdo temë tjetër relevante që nuk është përfshirë në rendin e ditës të bashkëngjitur, e që palët e gjykojnë të nevojshme.

C. PARASHTRIMET PËRPARA KONFERENCËS SË PARË MBI ECURINË E ÇËSHTJES

21. Gjithashtu, palët ftohen që, nëse dëshirojnë, të dorëzojnë parashtrime me shkrim, lidhur me cilindo nga materialet në rendin e ditës të bashkëngjitur ose ndonjë temë tjetër relevante që ata e gjykojnë të nevojshme. Në rast se informacionet nuk mund të shkëmbehen me palën tjetër për arsye konfidencialiteti dhe mbrojtjeje, parashtrimet mund të dorëzohen me shkrim *ex parte*. Informacionet e ofruara nga palët do ta ndihmojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake në përpilimin e vendimit kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështjeve lidhur me to, përfshirë afatin për nxjerrje të materialit.

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, e konsideron po ashtu të nevojshme të kërkojë dhënien e mendimeve me shkrim nga palët në lidhje me sistemin e redaktimit të informacionit dhe të provave që do të përdoret në këtë çështje gjyqësore sipas asaj që parashtrohet në “Vendimin kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse” në çështjen gjyqësore *Prokurori kundër Salih Mustafës*.¹⁰ Këto mendime do të shërbejnë si bazë informuese për Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e sistemit të redaktimit, që do të mundësojë efikasitetin e procesit të nxjerrjes së materialit nëpërmjet arritjes së një baraspeshe midis detyrimit për të mbrojtur interesat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe respektimit të të drejtave të të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.

¹⁰ KSC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi me nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para. 73-89.

23. Rikujtojmë këtu se, megjithëse të akuzuarit kanë të drejtë të jenë fizikisht të pranishëm në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, duke mbajtur parasysh natyrën teknike të temave që do të diskutohen, në konferencën mbi ecurinë e çështjes: (i) mund të jetë fizikisht i pranishëm i akuzuari, ndërsa mbrojtësi merr pjesë nëpërmjet videokonferencës; (ii) mund të jetë fizikisht i pranishëm mbrojtësi, ndërsa i akuzuari merr pjesë nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) mund të mos marrë pjesë i akuzuari, ndërsa mbrojtësi merr pjesë fizikisht ose nëpërmjet videokonferencës. Gjithsesi për këto masa është i nevojshëm pëlqimi me shkrim i të akuzuarit, pasi të jetë këshilluar me mbrojtësin në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores.

24. Nëse dëshirojnë të marrin pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës, mbrojtësit ose të akuzuarit duhet t'i paraqesin kërkesë drejtpërsëdrejti Administratores, në pajtim me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për videolidhjen (KSC-BD-23/COR),¹¹ brenda një kohe të mjaftueshme paraprake që do t'i jepte mundësi Administratores të ndërmernte hapat e duhur, përfshirë edhe informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹²

IV. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **REFUZON** kërkesat e Mbrojtjes për z. Gucati për një seancë gojore dhe mundësi për parashtrimin e kundërpërgjigjes në lidhje me rishikimin në pritje të procesit të paraburgimit;
- b. **VENDOS** të mbajë seancën në prani të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, sipas paragrafëve 18-20, të **premtën, më 8 janar 2021, në orën 15:00;**
- c. **KËRKON** nga ZPS-ja që të dorëzojë parashtrimet me shkrim: (i) për materialet e renditura në rendin e ditës të bashkëngjitur; (ii) për sistemin e

¹¹ KSC-BD-23/COR, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për videolidhje, neni 3(1).

¹² Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.

redaktimit që do të zbatohen në këtë proces gjyqësor; dhe/ose (iii) për tema të tjera relevante që konsideron të nevojshme, deri të **martën, më 5 janar 2021**; dhe

- d. **KËRKON** nga Mbrojtja që të dorëzojë parashtrimet me shkrim: (i) për materialet e renditura në rendin e ditës të bashkëngjitur; (ii) sistemin e redaktimit; dhe/ose (iii) për tema tjera relevante që konsideron të nevojshme, deri të **enjten, 7 janar 2021**.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 18 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë.